



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.10.2025  
Numër Protokolli: 7000/2025

A.nr.1237/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1237/2025, të datës 26.06.2025, të parashtruar nga ankuesi Rr.F, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.10.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1237/2025, e datës 26.06.2025, e parashtruar nga ankuesi Rr.F.
- II. **Mbetet në fuqi** Njoftimi Nr. 89/2025, i datës 30.05.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues në procedurën e pranimit Nr.ref: RN00016889, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve.

## A r s y e t i m

Ankuesi Rr.F (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 26.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me Nr. 89/2025, të datës 30.05.2025, të Divizionit për Burime Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues sipas konkursit me Nr.ref: RN00016889, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve, i shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (tutje referuar MASHTI), ndërsa kjo e fundit, më datë 15.07.2025, ka deponuar përgjigjen në ankesë, me pretendimet së procedura e kontestuar është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publikë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), pasi konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të kërkesave sipas nenit 129 të LPPA-së, administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4393/2025 të datës 26.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 05.11.2024 të ankuesit; Vendimin e datës 05.11.2024 për transferimin e ankuesit; Vërtetimin e datës 19.11.2024; Emailin e datës 30.05.2025 nga SIMBNJ për ankuesin; Njoftimin me Nr. 89/2025 i datës 30.05.2025; Formularin e vlerësimit të eses për ankuesin i datës 26.05.2025; Testin me shkrim të ankuesit; Ftesën për testim me shkrim e datës 12.05.2025; Njoftimin e datës 23.04.2025 nga SIMBNJ për ankuesin; Listën e kandidatëve të aprovuar; Vendimin e datës 14.04.2025 për vazhdimin e afatit për përfundimin e procedurës së vlerësimit; Konkursin me Nr. Ref: RN00016889, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 15.07.2025; Vendimin e datës 07.05.2025 për shtyrjen e afatit për përfundimin e testimit me shkrim; Vendimin me Nr. 2/1722 të datës 02.05.2025 për themelimin e komisionit të pranimit; Listën e aplikantëve; Listën e kandidatëve të testit me shkrim; Aplikacionin e ankuesit të datës 06.03.2025 me dokumentacionin e dorëzuar faqe 1-141; Aplikacionin e kandidatës fituese i datës 14.03.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-25; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për kandidaten fituese datës 28.05.2025; Formularët e vlerësimit të eses datë 26.05.2025; Esetë e katër kandidatëve që ju kanë nënshtruar testit me shkrim.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa **është e pabazuar, sepse:**

## **I. Gjendja e Çështjes:**

- MASHTI më datë 27.02.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Ref:RN00016889, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve, në kuadër të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, më afat aplikimi nga data 28.02.2025 deri me datë 29.03.2025.

-Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi duke u përfshirë në listën e ngushtë si kandidat që ka plotësuar kriteret formale për pozitën e shpallur dhe së i njëjti i është nënshtruar testimit me shkrim duke marr vetëm 38.6 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vijuar më fazën e intervistës me gojë.

-Divizioni për Burime Njerëzore në MASHTI me datë 30.05.2024 ka publikuar Njoftimin me Nr.89/2025 për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve, ku sipas këtij njoftimi kandidatja T.S-M është shpallur si kandidate fituese me gjithsej 94 pikë.

-Ankuesi brenda fatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar së procedura është përcjell me shkelje ligjore, sepse, CV-ja nuk më është vlerësuar me pikë të larta, ndërsa kandidatja fituese është vlerësuar maksimalisht sepse dyshoj që para testit me shkrim i janë dhënë përgjigjet e sakta dhe është lejuar të kopjoj. Nuk më është lejuar me hy në intervistë me gojë sepse ka pasur shkelje ndërsa në intervistë me gojë ka hyrë vetëm një kandidat e që sipas rregullativës ligjore nuk lejohet intervistë me gojë me një kandidat. Të gjitha konkursat e zhvilluara në vitin 2024 dhe 2025 për drejtorë dhe udhëheqës të divizioneve janë zhvilluar në mënyrë të kundërligjshme sepse janë përzgjedhur njerëz në mënyrë të kundërligjshme. Kandidatja fituese nuk ka plotësuar kushtet e konkursit. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet njoftimi i datës 30.05.2025, të verifikohet testet e kandidatëve dhe CV, të verifikohet të gjithë anëtarët e komisionit se a kanë qenë profesionalisht të duhur për këtë pozitë dhe të verifikohet nëse kandidatja e suksesshme ka plotësuar kushtet e konkursit.

## II. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit fillimisht ka analizuar shpalljen e konkursit me Nr. Ref: RN00016889, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve, si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Drejtimi Arsimi i Lartë i paspecifikuar; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve të ngritura në ankesë Kolegji i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike, më theks të veçantë:

**-Nenit 9 paragrafi 1:** 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”;

**- Nenit 44:** 1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësi përgjegjëse, në SIMBNj-së, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar prapë shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës. 10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative;

**-Nenit 45 paragrafi 2:** 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës/ës civil nga njësi përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

**- Nenin 7:** Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së

konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

**-Nenin 8:** 1.Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.

**-Neni 9:** 1.Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë .4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni behët publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

**-Nenin 10:** Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitë e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e

*Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.*

**-Nenin 11:** *Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Bazuar në kuadrin ligjor si më lartë, kolegji ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje juridike-administrative, ku dhe si pasojë e këtij shqyrtimi dhe analizimi ka gjetur se më Vendimin me Nr.2/1722, të datës 02.05.2025, të Sekretares së Përgjithshme të MASHTI-it, është emëruar Komisioni i Pranimit në përbërje të rregullt nga B.M, Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Investimeve dhe Projekteve në Hapësirat Arsimore; në cilësi të kryesuesit, nerva, si anëtarë janë caktuar: R.P, Udhëheqës e Divizionit për Monitorim të Kontratave dhe Punës Nder-sektoriale; N.S, Udhëheqës i Divizionit për Arsim të Komuniteteve, Xh.B, Udhëheqës i Divizionit për Prokurim Publik, dhe A.K, Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore, pra, në vlerësimin e Kolegjit përbërja e Komisionit ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 45 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht, mbi këtë fakt, rezulton se nuk qëndron pretendimi ankimor i ngritur si në ankesë lidhur me përbërjen e kamionit të pranimit.

Përkitazi më pretendimin ankimore të ankuesit se CV-ja nuk i është vlerësuar me pikë të larta ndërsa kandidata fituese është vlerësuar maksimalisht, Kolegji vë në dukje faktin se vlerësimi i CV-së së kandidateve në fazën e vlerësimit profesional vie në shprehje vetëm në intervistën më gojë. Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i provave materiale të çështjes është konstatuar se testi me shkrim ka përmbajt 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja, kështu që, pyetjet e testit kanë qenë përgatitura në pajtim më kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ndërsa, ankuesi ka dhënë 13 përgjigje të sakta tek pyetje me disa opsione, duke arritur 26 pikë ( çdo përgjigje e saktë e vlerësuar më dy pikë) ndërsa, në ese është vlerësuar nga Komisioni i Pranimit me 12.6 pikë nga 20 pikët maksimale, duke arritur gjithsej 38.6 pikë, pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim...*. Ne fakt, Kolegji nuk verën vlerësim jo të drejtë të ankuesit në testin më shkrim, sepse, ankuesi ka dhënë vetëm 13 përgjigje të sakta tek pyetjet më shumë zgjidhje, ndërsa, sikurse në ese të vlerësohej edhe më 20 pikë maksimale, ankuesi serish nuk do arrinte numrin e mjaftueshme të pikëve tu konsideruar si prag i kalueshëm i testit më shkrim, andaj, mbi këto konstatime pretendimet ankimor mbi këtë bazë nuk janë të pranueshme.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se kandidates fituese i janë dhënë përgjigjet e sakta të testit me shkrim dhe është lejuar të kopjoj, Kolegji në mungesë të provave materiale nuk ka arritur të vërtetoj këtë pretendim të ankuesit.

Referuar pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me intervistën me gojë se për shkak të shkeljeve nuk i është lejuar hyrja në intervistë me gojë dhe se në intervistë me gojë duhet të jenë se paku dy kandidatë, Kolegji bazuar në konstatimin si me sipër rithekson faktin se ankuesi nuk ka mundur ti nënshtrohet intervistës me gojë sepse i njëjti nuk ka arritur numrin e nevojshëm të pikëve në testin me shkrim pra nuk ka arrit se paku 50 pikë, dhe se se me asnjë dispozitë të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk parashihet se në intervistë me gojë duhet të jenë se paku dy kandidatë.

Kolegji nuk ka trajtuar pretendimin e ankuesit se të gjitha konkurset e zhvilluara në vitin 2024 dhe 2025 për drejtorë dhe udhëheqës të divizioneve janë zhvilluar në mënyrë të kundërligjshme, sepse, procedurat e pranimit mund të kontestohen vetëm nga kandidatet aplikues dhe atë brenda afateve ligjore, ndërsa, ankuesi me asnjë dëshmi nuk ka rritur të argumentoj se ka qenë kandidat në këto procese, përjashtimisht procedurës për Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve.

Ndërsa, lidhur me pretendimin së kandidatja fituese nuk ka plotësuar kushtet e konkursit, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e kandidates fituese T.S.M të dorëzuar me rastin e aplikimit më datë 14.03.2025( dokumentacion i përcjell me rastin e përgjigjes në ankesë) dhe si pasojë ka gjetur së kandidatja zotëron Diplomën me Nr. 815/09, të datës 22.12.2009, të lëshuar nga Kolegji AAB-RIINVEST, më të cilën dëshmohet se më datë 17.11.2009, ka përfunduar studimet themelore në Programin Menaxhment dhe Informatikë, duke marr titullin Baçelor i Shkencave në Menaxhment dhe Informatikë. Ndërlidhur me përvojën e punës kandidatja e shpallur fituese ka ofruar si dëshmi: Vërtetimin Nr.ref.23/2025 të datës 14.03.2025, të lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të MASHTI-it, më të cilën konfirmohet së e njëjta nga data 10.07.2003 deri më datë 31.12.2012, ka ushtruar pozitën Teknik për Inventar dhe Mirëmbajtje; nga 31.12.2012 deri më datë 13.10.2014, ka ushtruar pozitën Asistente Administrative,; prej datës 13.10.2014 deri më datë 01.04.2022, ka mbajtur pozitën Zyrtare për Teknologji Informative; nga data 01.04.2022 deri më datë 29.09.2023, ka ushtruar pozitën Zyrtare e Lartë për Teknologji Informative; prej datës 29.09.2023 deri më datë 05.11.2024, ka qenë ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të TI dhe Shërbimeve Logjistike dhe prej datës 05.11.2024 deri në lëshimin e këtij vërtetimi, ka qenë ushtruese e detyrës së Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme. Andaj, mbi bazën e këtyre dëshmive rezulton se e njëjta ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit që ndërlidhen me arsimim dhe përvojën e punës profesionale, e duke qenë se ka arritur edhe numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, më të drejtë njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore të MASHTI-it e ka shpallur si kandidate fituese sikurse parashihet me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si me lartë, dhe duke qenë se nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale ligjore, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura e kontestuar me ankesë është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

**VENDOSI:**

Refuzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të Njoftimit Nr. 89/2025, të datës 30.05.2025, i Divizionit për Burime Njerëzore i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues në procedurën e pranimit Nr. ref: RN00016889, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve.

**KËSHILLË JURIDIKE:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1237/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit Rr.F;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MASHTI; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.